



Prot. Nr. 32

Tiranë më: 26 .02.2025

Lënda: Njoftim për hapjen e thirrjes së dytë për aplikime në Programin e Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për Certifikim për drejtues të Institucioneve të Arsimit Parashkollor 3 Mars-3 Prill 2025.

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

Rruga e Durrësit 23, Tiranë

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rr. "Aleksandër Moisiu". përballë IKV, Tiranë

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME E ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

Rruga e "Barrikadave" 1001, Tiranë

Shkolla e Drejtorëve të IAP hap më 3 Mars thirrjen e dytë për aplikime në Programin e Trajnimit të Detyrueshëm Përgatitor për Certifikim të Drejtuesve të Arsimit Parashkollor.

Kjo thirrje është e hapur për drejtuesit në detyrë të institucioneve të arsimit parashkollor si dhe për mësuesit që ushtrojnë ose kanë ushtruar këtë profesion, si në institucione publike ashtu edhe në ato private.

Kriteret e aplikimit për drejtorët në detyrë dhe mësuesit që aspirojnë të bëhen drejtues:

- Të kenë diplomë universitare "Bachelor" në mësuesi për arsimin parashkollor;
- Të kenë jo më pak se 3 vite përvojë pune si mësues në arsimin parashkollor;
- Të mos kenë masa disiplinore në fuqi në momentin e aplikimit.

Aplikimi për Programin e Trajnimit kryhet vetëm online në faqen zyrtare të Shkollës së Drejtorëve, përmes seksionit të dedikuar të aplikimit: <https://www.csl.edu.al/>.

Center for School Leadership
+355 4 220 9185
info@csl.edu.al
Adresa: Bulevardi "Zhan d'Ark", Nr. 23, Tiranë, Shqipëri

www.csl.edu.al



Bazuar në Nenin 10 të Rregullores "Për Zhvillimin Profesional dhe Kualifikimin e Drejtorëve/Nëndrejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parashkollor në Shqipëri", aplikimet do të shqyrtohen nga Komisioni i Vlerësimit, pas përfundimit të afatit të aplikimeve, sipas kriterëve dhe pikëzimit të përcaktuar në rregullore.

Komisioni i Vlerësimit do të përbëhet nga dy përfaqësues të MAS dhe një përfaqësues nga Shkolla e Drejtorëve të IAP. Në varësi të numrit të aplikimeve, mund të krijohen komisione shtesë për të siguruar vlerësimin brenda afateve të përcaktuara.

Të gjitha detajet mbi thirrjen janë të disponueshme në faqen zyrtare të Shkollës së Drejtorëve: www.csl.edu.al.

Shkolla e Drejtorëve të IAP do të informojë dhe promovojë thirrjen përmes të gjitha kanaleve të saj të komunikimit.

Duke vlerësuar bashkëpunimin me institucionet në varësinë tuaj, besojmë se shpërndarja e këtij informacioni përmes kanaleve tuaja të komunikimit do të mundësojë një informim të gjerë për të gjithë drejtuesit dhe mësuesit e interesuar.

Faleminderit për bashkëpunimin.
Me konsideratë,

DREJTOR EKZEKUTIV
Dr. Jola Kepi